

VENDIM

Nr. 78, datë 30.5.2019

(Ndryshuar me vendimin nr. 254, datë 9.5.2024; nr. 235, datë 6.5.2026)

(i përditësuar)

PËR KALENDARIN E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE NË GJYKATËN E APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, të pikës 1, të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në shkronjën “e”, pika 4, të nenit 94, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bazuar në pikën 4, të nenit 460, të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me përcaktimin e rregullave të hollësishme për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit,

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit *ose listën e grup-çështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës*.

1/1. *Listat e shqyrtimit të grup-çështjeve të caktuara në përjashtim të rregullit të shqyrtimit sipas kohës së regjistrimit të tyre, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe të efektivitetit të gjykimeve dhe uljes së çështjeve të prapambetura, hartohen nga Këshilli i Gjykatës pasi të jetë marrë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.*

2. Caktimi i datës dhe orës së shqyrtimit të çështjes së regjistruar në gjykatën e apelit, kur kjo e fundit vepron si gjykatë e shkallës së parë, bëhet nga gjyqtari relator në respektim të rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, duke mbajtur parasysh objektin e çështjes dhe kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve.

3. Për një çështje, për të cilën Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë ka përcaktuar afat për gjykimin e saj, në caktimin e datës dhe orës së shqyrtimit, gjyqtari relator mban parasysh edhe afatin e posaçëm ligjor të gjykimit të çështjes.

4. Për një çështje, për të cilën Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë nuk ka përcaktuar afat për gjykimin e saj, në caktimin e datës dhe orës së shqyrtimit, në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve (kalendarin me datat e planifikuara të gjykimeve), gjyqtari relator mban parasysh afatin e arsyeshëm sipas nenit 399/2, të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017.

5. Për një çështje, shqyrtimi i të cilës i është ngarkuar si relator një gjyqtari nga një gjykate apeli tjetër, gjyqtari relator mban parasysh dhe ngarkesën, si edhe kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën nga e cila vjen.

6. Për një çështje, shqyrtimi i të cilës i është ngarkuar edhe një gjyqtari nga një gjykatë apeli tjetër, gjyqtari relator mban parasysh dhe ngarkesën, si edhe kalendarin e shqyrtimit të çështjeve të këtij gjyqtari.

KREU II

RASTET E PËRSHPËJTIMIT TË ÇËSHTJEVE

1. Shqyrtimi i një çështje, për të cilën Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë nuk ka përcaktuar afat për gjykimin e saj, mund të përshpejtohet mbi kërkesë të palëve, për shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes ose për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të

motivuar, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin ose në përputhje me listën e grup-çështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës.

2. Gjyqtari relator cakton datën në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve duke mbajtur parasysh kërkesat për përshpejtim ose listën e grup-çështjeve të miratuara nga Këshilli i Gjykatës. Kriteret që mban parasysh gjyqtari relator për vlerësimin e shkaqeve për përshpejtim të parashtruara nga palët lidhen në veçanti me natyrën dhe kategorinë specifike të çështjes.

3. Çështje me natyrë dhe kategori specifike në kuptim të këtij vendimi janë ato çështje, ku mungesa e shqyrtimit të tyre brenda një afati më të shkurtër se afati i arsyeshëm sipas nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017, pas sjell pasoja të rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë.

3.1 Çështje të tilla, sipas natyrës, janë:

- a) çështjet që kanë për objekt të drejta të fëmijës apo që kanë ndikim tek një fëmijë i mitur;
 - b) çështjet me objekt zgjidhje ose pavlefshmëri martese;
 - c) çështjet me objekt detyrim për ushqim;
 - ç) çështjet me objekt kujdestarinë;
 - d) çështjet me objekt heqjen, kufizimin ose kthimin e zotësisë për të vepruar dhe ato që kanë për objekt të drejta të personave që iu është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar;
 - dh) çështjet me objekt birësimin;
 - e) çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë është shprehur me vendim jopërfundimtar, ndaj të cilit është ushtruar e drejta e ankimit të veçantë, të tilla si: çështjet me objekt ndreqje gabimi, sqarim ose interpretim të vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e ankimit në gjykatën e apelit kundër vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; çështjet me objekt rivendosjen në afat të ankimit në gjykatën e apelit; çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur kthimin e akteve ose pushimin e gjykimit apo pezullimin e gjykimit;
 - ë) çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur refuzimin e dhënies/lëshimit të urdhrit të ekzekutimit;
 - f) çështjet me objekt plotësim të vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë;
 - g) çështjet me objekt vërtetim fakti juridik i vjetërsisë në punë ose njohjen e vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit me pasoja juridike sa i përket përfitimit të pensionit si dhe çdo çështje me pasoja juridike për përfitimin e pensionit.
 - gj) çështjet me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga marrëdhënia e punës apo ato që rrjedhin nga shpërblimi i dëmit nga zgjidhja e marrëdhënies së punës.
 - h) çështjet në të cilat pala që ka paraqitur ankim heq dorë nga ankimi ose ato në të cilat paditësi heq dorë nga e drejta e padisë;
 - i) çështjet në të cilat pala ka paraqitur ankim jashtë afatit, kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim apo nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim;
 - j) çështjet që përfitojnë nga amnistia sipas ligjit përkatës;
 - k) vendimet e ndërmjetme me objekt sigurim padie apo pjesëtim pasurie faza e parë;
 - l) gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit;
 - ll) çështjet për cilat padia nuk e kalon vlerën e 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekëve;
 - m) çështjet me objekt strehimin social;
 - n) çështjet që kanë për objekt të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- Këshilli i Gjykatës, me propozim të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, mund të hartojë listën e grup-çështjeve përtej kriterëve të mësipërme me qëllim mbrojtjen e interesit publik, përmirësimin e shpejtësisë dhe efektivitetit të gjykimit dhe miradministrimin e drejtësisë.
- nj) Çështjet e pronësisë që lidhen me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve;
- o) Çështjet që lidhen me kontratat konsumatore dhe paditë kolektive për mbrojtjen e konsumatorit;

p) Çështjet me objekt mbrojtjen e mjedisit dhe të klimës.

3.2 Çështje të tilla, sipas kategorisë, janë:

a) çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin/dërgimin për rigjykim në gjykatën e apelit;

b) çështjet që kanë ardhur për gjykim në gjykatën e apelit pas rigjykimit të tyre në gjykatën e shkallës së parë;

c) çështjet që duhen shqyrtuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

4. Përveç sa parashikohet në pikat 3.1 dhe 3.2 të këtij Kreu, për çdo lloj çështje, pavarësisht natyrës dhe kategorisë së saj, palët mund të kërkojnë përshpejtimin e shqyrtimit të saj për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin. Këto shkaqe vlerësohen nga gjyqtari relator sipas bindjes së tij të brendshme, bazuar në rrethanat e parashtruara nga pala.

5. Me “shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara” nënkuptohen ato shkaqe personale të palës të lidhura me shqyrtimin e çështjes dhe objektin e saj apo ato shkaqe që përcaktojnë ose kushtëzojnë ecurinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes kryesore të palëve ndërgjyqëse, shkaqe këto, ekzistenca e të cilave, motivon shqyrtimin e përshpejtuar të çështjes, domethënë shqyrtimin e saj në një afat më të shkurtër nga afati ligjor apo nga afati i arsyeshëm sipas nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të Ligjit nr.38/2017, datë 30.3.2017.

6. “Shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara” mund të jenë, pa u kufizuar, si vijon:

a) pamundësia objektive e palës për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në një të ardhme të caktuar, ndërsa ajo ka zgjedhur që mbrojtjen e interesave të saj në gjykim ta realizojë personalisht apo kur prania e saj në gjykim konsiderohet e qenësishme për efekt të procesit të të provuarit;

b) gjendja shëndetësore e palës apo mosha e saj, është e tillë që mund të vërë në dyshim pritshmërinë e saj për një vendim gjyqësor që lidhet me një të drejtë personale;

c) çështja ka përbërë shkak pezullimi për një çështje tjetër gjyqësore;

ç) çështjet, shqyrtimi i të cilave në gjykatën e shkallës së parë ka zgjatur përmbi 2 vjet;

d) çështjet të cilat ligji i ka përcaktuar në juridiksionin fillestar gjyqësor të gjykatës së apelit dhe shqyrtimi i të cilave në juridiksionin administrativ ka zgjatur përmbi 2 vjet.

KREU III

KËRKESA PËR PËRSHPEJTIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES, PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I SAJ

1. Kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes bëhet në formë të shkruar dhe duhet të nënshkruhet, me pasojë refuzimin e shqyrtimit, nga vetë pala apo përfaqësuesi i saj, i zgjedhur me prokurë ose me deklaram përpara gjykatës.

2. Në kërkesën për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes pala tregon shkakun konkret dhe, kur është rasti, e shoqëron atë me provat përkatëse që vërtetojnë shkakun. Pala apo përfaqësuesi i saj, në kërkesë shënon edhe të dhënat elektronike të kontaktit apo numrin e telefonit me qëllim mundësimin e njoftimit të tij për fatin e kërkesës.

3. Kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes depozitohet në zyrën e sekretarisë gjyqësore të gjykatës së apelit ku është regjistruar çështja, nga vetë pala apo përfaqësuesi i saj, duke u identifikuar nëpërmjet një dokumenti të vlefshëm identifikimi, fotokopja e të cilit i bashkëngjitet kërkesës. Në momentin e paraqitjes së kërkesës, nëpunësi civil gjyqësor përgjegjës i sekretarisë gjyqësore verifikon të dhënat e personit që paraqet atë, si dhe shënimin në kërkesë të të dhënave elektronike të kontaktit apo numrit të telefonit dhe, kur është rasti, i kërkon paraqitësit të kërkesës plotësimin aty për aty të këtyre të dhënave.

4. Nëpunësi civil gjyqësor përgjegjës i sekretarisë gjyqësore, jo më vonë se dita e nesërme e punës, kërkesën ia dorëzon sekretarit gjyqësor të gjyqtarit relator, ndërsa sekretari gjyqësor kujdeset që kërkesa t’i vihet sa më parë në dispozicion gjyqtarit relator.

5. Në rastin kur gjyqtar relator është një gjyqtar i një gjykate tjetër apeli, që është caktuar për shqyrtimin e çështjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes i dërgohet atij në rrugë elektronike, në adresën zyrtare.

6. Sekretari gjyqësor i gjyqtarit relator, jo më vonë se 2 ditë nga dorëzimi atij të kërkesës, pasqyron në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve faktin e paraqitjes së kërkesës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

7. Gjyqtari relator shqyrton kërkesën e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës.

8. Kur kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes vlerësohet e bazuar, gjyqtari relator, vendos pranimin e saj, duke parashtruar dhe arsyet në lidhje me vlerësimin e tij. Në këtë rast, në varësi të ngarkesës dhe të urgjencës së çështjes, edhe intervalin kohor brenda të cilit çështja do të planifikohet në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve. Sekretari gjyqësor i gjyqtarit relator kujdeset për ndjekjen e planifikimit të çështjes në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve sipas planifikimit paraprak në aktin përkatës të gjyqtarit relator.

9. Kur kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes vlerësohet e pabazuar, gjyqtari relator, përmes një shënimi me shkrim dore në trupin e kërkesës, vendos refuzimin e saj. Gjyqtari relator shënon edhe datën kur e shqyrtoi kërkesën, duke nënshkruar poshtë shënimit të tij.

10. Në rastin e gjyqtarit relator nga një gjykatë tjetër apeli, i caktuar për shqyrtimin e çështjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, akti i tij për pranimin e kërkesës së palës për përshpejtimin e shqyrtimit ose urdhërimi i tij për refuzimin e kësaj kërkesë, i përcillet sekretarisë gjyqësore së gjykatës ku është çështja, në rrugë elektronike.

11. Kërkesa e refuzuar që paraqitet sërish mbi të njëjtat arsye, si rregull refuzohet.

12. Sekretari gjyqësor i gjyqtarit relator, mbasi merr nga ky i fundit aktin e urdhërimit të tij për kërkesën, kujdeset për plotësimin në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të të dhënave në lidhje me urdhërimin përkatës të gjyqtarit relator, si edhe për njoftimin, palës që ka paraqitur kërkesën për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, të këtij urdhërimi. Njoftimi i palës bëhet në të dhënat e kontaktit të paraqitura prej saj, duke pasur ajo të drejtë të tërheqë, pranë sekretarisë gjyqësore të gjykatës së apelit, fotokopjen e dokumentit ose kopjen në letër të komunikimit elektronik me gjyqtarin relator, ku pasqyrohet urdhërimi i gjyqtarit relator mbi kërkesën për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

13. Kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes me shënimin e gjyqtarit relator dhe, kur është rasti, akti i veçantë i nxjerr nga ai ose kopja në letër të komunikimit elektronik në rastin e gjyqtarit relator nga një gjykatë tjetër apeli, i caktuar për shqyrtimin e çështjes me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, administrohen në dosjen gjyqësore përkatëse.

14. Në çështjen, për të cilën është vendosur përshpejtimi i shqyrtimit të saj, gjyqtari relator iu bën me dije palëve, në fillim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, faktin se ajo është planifikuar me përshpejtim, duke urdhëruar sekretarinë gjyqësore që t'u vërë në dispozicion palëve të pranishme fotokopjen e kërkesës për përshpejtim dhe aktin përkatës të nxjerr nga ai. Njoftimi i palëve për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes bëhet sipas kërkesave të nenit 460, pikat 5 e 6, të Kodit të Procedurës Civile. Krahas këtij njoftimi, gjyqtari relator urdhëron edhe njoftimin e drejtpërdrejt të palëve, përfaqësuesve të tyre ose prokurorit, sipas rregullave të pjesës I, titulli VI, kreu IV, "Njoftime", të Kodit të Procedurës Civile.

KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Kërkesat e paraqitura nga palët për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjeve, të pashqyrtuara ende deri në datën e fillimit të efekteve të këtij vendimi, do t'i nënshtrohen rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Deri në momentin e mundësimit nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të një raportit tërësor të të dhënave në lidhje me kërkesat e palëve për përshpejtimin e shqyrtimit të

çështjeve, hedhja e të dhënave bazë bëhet në një regjistër të veçantë vjetor në letër, në të cilin, në rend kronologjik, në çdo rresht dhe sipas rubrikave të veçanta, përshkruhen këto të dhëna: numri rendor; kërkuesi (emër dhe mbiemër); çështja (numri dhe data e regjistrimit); data e depozitimit të kërkesës; gjyqtari relator i çështjes (emër dhe mbiemër).

3. Kryetarët dhe kancelarët e gjykatave të apelit marrin masa për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të veçantë të kërkesave për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjeve.

4. Në përfundim të procesit të analizimit dhe klasifikimit të çështjeve të prapambetura, Këshilli i Gjykatës merr masa për krijimin e listave të grup-çështjeve sipas pikës 1.1 të këtij vendimi dhe ia përcjell ato menjëherë gjyqtarëve, ndihmësve ligjorë të caktuar.

5. Këshilli i Gjykatës raporton çdo 3 muaj në Këshillin e Lartë Gjyqësor për ecurinë e shqyrtimit të çështjeve të prapambetura sipas listave të grup-çështjeve sipas formatit të raportimit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet 30 ditë pas hyrjes në fuqi.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

(shtuar me vendimin nr. 254, datë 9.5.2024)

SHTOJCA 1

Formati i raportit 3-mujor për ecurinë e shqyrtimit të çështjeve të prapambetura sipas listave të grup-çështjeve:

1. Gjykata

Shënim. Vendosi gjykatën përkatëse.

2. Periudha e raportimit

Shënim. Duhet të evidentojë periudhën 3-mujore të zbatimit

3. Pasqyrë e përgjithshme e çështjeve të grupuara në kategoritë përkatëse të grup-çështjeve dhe vendimmarrja e gjykatës

Shënim. (Shtoni kategoritë e grup-çështjeve për të cilat janë përgatitur listat përkatëse, numrin e çështjeve të kategorizuara në atë grup-çështje, vendimmarrjen e gjykatës dhe raportin ndërmjet çështjeve në kategori dhe atyre të gjykuara nga po ajo kategori i shprehur në përqindje.)

Në tërësi, nga XXX çështje të kategorizuara në grup-çështje gjatë periudhës XXX-XXX 202X, janë marrë XXX vendime. Në vijim, paraqitet tabela e përqindjes së vendimmarrjes së gjykatës për çdo kategori.

Nr.	Kategoria e grup-çështjes prioritare për shqyrtim	Numri i çështjeve në kategori	Numri i vendimeve të marra nga gjykata	Përqindja përkundrejt vendimmarrjes
1				
2				
3				
	Gjithsej			

Sqarime të mëtejshme:

Shënim. Raportimi duhet të përfshijë ecurinë e shqyrtimit të çështjeve të kategorizuara, duke dhënë një përmbledhje të problematikave nëse ka.

4. Raporte statistikore me të dhëna mbi kategoritë, numrin e çështjeve të klasifikuara në to dhe numrin e vendimeve të marra nga gjykata, për çdo gjyqtar

Shembull (Duhet të evidentojë numrin e grup-çështjeve në të gjitha kategoritë sipas

gjyqtarëve të gjykatës, vendimmarrjen e gjykatës dhe raportin ndërmjet çështjeve në të gjitha kategoritë dhe atyre të gjykuara nga kategoritë i shprehur në përqindje.)

Pasqyra e përgjithshme e çështjeve të grupuara në kategori sipas gjyqtarit				
Gjyqtari	Numri i çështjeve të grupuara në kategori	Numri i çështjeve për të cilat është marrë vendim n	Numri i çështjeve për t'u marrë vendim	Përqindja
Gjithsej				

Shënim. (Duhet të evidentojë numrin e çështjeve në një kategori të caktuar sipas gjyqtarëve të gjykatës, vendimmarrjen e gjykatës dhe raportin ndërmjet çështjeve në atë kategori dhe atyre të gjykuara brenda kësaj kategorie i shprehur në përqindje.) Shtoni tabela të veçanta për secilën kategori.

Kategoria 1. Sipas gjyqtarëve					
Gjyqtari	Numri i çështjeve në kategori	Numri i çështjeve për të cilat është marrë vendim nga gjykata	Numri i çështjeve për t'u marrë vendim	Përqindja	Shënime
Gjithsej					

Kategoria 2. Sipas gjyqtarëve					
Gjyqtari	Numri i çështjeve në kategori	Numri i çështjeve për të cilat është marrë vendim nga gjykata	Numri i çështjeve për t'u marrë vendim	Përqindja	Shënime
Gjithsej					

5. Raporte statistikore me të dhëna mbi kategoritë, numrin e çështjeve të klasifikuara në to dhe numrin e vendimeve të marra nga gjykata, për çdo ndihmës ligjor

Shembull *(Duhet të evidentojë numrin e grup-çështjeve në të gjitha kategoritë sipas ndihmësve ligjorë të gjykatës, vendimmarrjen e gjykatës dhe raportin ndërmjet çështjeve në të gjitha kategoritë dhe atyre të gjykuara nga kategoritë, i shprehur në përqindje.)*

Pasqyra e përgjithshme e çështjeve të grupuara në kategori sipas ndihmësve ligjorë					
Ndihmësi ligjor	Numri i çështjeve të grupuara në kategori	Numri i çështjeve të përgatitura	Numri i çështjeve për të cilat është marrë vendim	Numri i çështjeve për t'u marrë vendim	Përqindja
Gjithsej					

Shënim. (Duhet të evidentojë numrin e çështjeve në një kategori të caktuar sipas ndihmësve ligjor, vendimmarrjen e gjykatës dhe raportin ndërmjet çështjeve në atë kategori dhe atyre të

gjykuara brenda kësaj kategorie i shprehur në përqindje.) Shtoni tabela të veçanta për secilën kategori.

Kategoria nr. 1. Ndhmësit ligjorë					
Ndhmësi ligjor	Numri i çështjeve të grupuara në kategori	Numri i çështjeve të përgatitura	Numri i çështjeve për të cilat është marrë vendim	Numri i çështjeve për t'u marrë vendim	Përqindja
Gjithsej					

Kategoria nr. 2. Ndhmësit ligjorë					
Ndhmësi ligjor	Numri i çështjeve të grupuara në kategori	Numri i çështjeve të përgatitura	Numri i çështjeve për të cilat është marrë vendim	Numri i çështjeve për t'u marrë vendim	Përqindja
Gjithsej					

6. Vështirësitë për përmbushjen e objektivave

7. Rekomandime për përmirësimin e objektivave, hapave dhe aktiviteteve konkrete